

OBSH

Përgjigjia ndaj kërcënimit të pandemisë së gripit të shpendëve

Veprimet strategjike të rekomanduara

(Perkthyer nga G.Kashari, E.Gjikopulli, M.Kellezi
Redaktimi nga V.Miho
OBSH)

Qëllimi

Duke iu drejtuar politikëbërësve ky dokument gjithashtu përshkruan çështje që mund të orientojnë drejt zgjedhjeve politike të cilat mund të ndërmerren në një situatë që karakterizohet si nga urgjenca ashtu dhe pasiguria.

Duke parë afersinë e kërcënimit, OBSH-ja rekomandon që të gjitha vendet të ndërmarrin veprime urgjente për t'u përgatitur për pandeminë dhe ka hartuar një plan vendi model që do t'u japë shumë vendeve në zhvillim një start të mirë në vlerësimin e gjendjes së tyre të përgatitjes dhe në indentifikimin e nevojave përparësore.

Mundësitë për ndërhyrje

Gjatë fazës aktuale para-pandemike, ndërhyrjet synojnë të reduktojnë riskun e lindjes së një virusi pandemik dhe të grumbullojnë informacion më të mirë, veçanërisht për sa i takon ndryshimeve në sjelljen e virusit që mund të sinjalizojë përmirësim të transmetueshmërisë së tij.

Mundësia e dytë për të ndërhyrë ndodh në ko incidencë me sinjalin e parë kur virusi ka përmirësuar transmetueshmërinë e tij dhe synon të ndryshojë historinë e hershme të pandemisë. Mundësia e fundit ndodh pasi pandemia ka filluar.

Ndërhyrjet në këte pike synojnë të reduktojnë semundshmërinë, vdekshmërinë dhe problemet sociale.

Objektivat

Faza para-pandemike

- 1. Reduktimi i mundësive për infeksionin e njeriut.**
- 2. Përforcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm.**

Faza e shfaqjes së një virusi pandemik
--

- 3. Frenimi ose vonesa e përhapjes tek burimi**

4 Reduktimi i sëmundshmërisë, vdekshmërisë dhe probleme sociale
5 Kryerja e punëve kërkimore që do të shërbenin si guide për masat me të cilat do ti përgjigjeshim pandemisë.

Sfondi i zhvillimit.

Historikisht pandemitë e gripit a kanë zënë botën në befasi, duke i lënë shërbimeve shëndetësore pak kohë për t'u përgatitur për shtimin e papritur të rasteve dhe vdekjeve që karakterizojnë këto ngjarje dhe i bëjnë këto kaq shkatërruese. Vaksinat, që janë ndërhyrjet më të rëndësishme për reduktimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë ishin të disponueshme për viruset e pandemive të 1957 dhe 1968, por mbërriten tepër vonë për të pasur një impakt. Si rezultat këto pandemi u shoqëruan me probleme sociale të mëdha dhe ekonomik si dhe me humbje jetësh.

Situata aktuale është shumë më e ndryshme për disa arsye. Sëpari, bota është paralajmëruar me kohë. Për më tepër se një vit kushtet që favorizojnë një pandemi tjetër janë shpalosur në pjesë të Azisë. Paralajmërimet se pandemia mund të jetë e shpejtë kanë ardhur si nga ndryshimet në epidemiologjinë e sëmundjes tek njerezit dhe tek kafshët ashtu dhe nga një prani gjeografike në shtrirje të virusit, duke krijuar mundësi të mëtejshme për ekspozimin e njeriut. Ndërsa qoftë koha ashtu edhe graviteti i pandemisë së ardhshme nuk mund të parashikohen, faktet se virusi në popullatat e shpendëve tani është endemik tregon se niveli aktual i riskut nuk do të pakësohet lehtë.

Sëdyti, ky paralajmërim ka ofruar një mundësi të paparë për t'u përgatitur për një pandemi dhe për të gjetur mënyra për të zbutur efektet e tij. Sot, veprimtaritë kryesore të ndërmarrja nga vendet janë përqëndruar në përgatitjen dhe testimin e planeve të përgjigjes (reagimit) ndaj pandemisë, prodhimin e një vaksine ndaj virusit dhe sigurimin e furnizimeve me medikamente antivirale. Por meqë këto veprimtari janë të kushtueshme vendet e pasura janë sot të përgatitura më mire. Vendet ku H5N1 është endemik dhe ku ka më tepër të ngjarë që të shfaqet një virus pandemik, janë tepër mbrapa. Tani më tepër vende kanë plane të përgatitjes për pandeminë. Rreth një e pesta e vendeve të botës kanë një lloj plani veprimi, por këto variojnë shumë për sa i takon plotësisë së tyre dhe stadi ku ndodhen. Aksesit tek medikamentet antivirale dhe çka është më e rëndësishme tek vaksinat mbetet një problem i madh për shkak të kapaciteteve të kufizuara si dhe kostos. Rreth 23 vende kanë porositur medikamente antivirale për rezerva kombëtare, por prodhuesi kryesor nuk do të jetë i aftë të plotësojë të gjitha porositë për të paktën edhe për një vit tjetër. Më pak se 10 vende kanë kompani vaksinash të tyre të angazhuara në punën për një vaksinë pandemike. Një konsultim i OBSH-se në nëntor 2004 arriti në përfundimin e fortë se me tendencën aktuale, shumica e vendeve në zhvillim nuk do të kishte akses ndaj një vaksine gjatë valës së parë të pandemisë dhe ndoshta gjatë gjithë kohës.

Vlerësimi i gjendjes.

1 Rreziku i një pandemie është i madh

Që nga fundi i vitit 2003 bota i është qasur një pandemie më afër se kurrë ndonjëherë që prej 1968, kur ndodhi pandemia e fundit e shekullit të kaluar. Të gjitha parakushtet për një pandemi përveç njerit tashmë janë plotësuar. Ky është kontakti nga njeriu tek njeriu. Gjatë 2005 janë parë ndryshime të frikshme të epidemilogjisë dhe semundjes tek kafshet. Raste tek njerëzit po vazhdojnë të ndodhin dhe virusi e ka zgjeruar shtrirjen e tij gjeografike duke përfshirë vende të reja, duke rritur kështu numrin e popullsisë nën risk. Çdo rast i ri tek njeriu i jep mundësinë virusit që të transformohet drejt një shtami terësisht të transmetueshëm pandemik.

2 Rreziku do të vazhdojë

Faktet tregojnë se virusi H5N1 tani është endemik në pjese të Azisë, duke krijuar një fole ekologjike tek pulat. Rreziku për raste të tjera tek njerëzit do të vazhdojë ashtu si dhe mundësitë për shfaqjen e një virusi pandemik. Shperthimet kanë ndodhur e pavarësisht masave agresive të kontrollit, përfshirë eliminimin (therrjen e sforcuar) e 140 milion pulave. Shpendet e egra shtegtuese, historikisht rezervuari strehues i të gjitha viruseve të gripit A, tani po ngordhin në numër të madh nga virusi patogjen H5N1. Patat shtëpijake mund të jashtëqesin sasi të mëdha të virusit tepër patogjenik pa treguar shenja të semundjes. Roli i tyre i heshtur në ruajtjen e transmetimit e nderlikon me tej kontrollin tek pulat dhe e bën më të vështirë shmangien nga njerëzit të sjelljeve me risk.

3 Evolucionin e këtij kërcënimi nuk mund të parashikohet

Duke marrë parasysh natyrën ndryshuese të viruseve të gripit, atëherë koha dhe graviteti i pandemisë të ardhshme nuk mund të parashikohet. Hapi përfundimtar, pra përmirësimi i transmetueshmërisë nga njeriu tek njeriu mund të ndodhë me anë të dy mekanizmave. Ri-llojzim që nënkupton shkëmbimin e materialit gjenetik midis viruseve të njeriut dhe shpendeve gjatë bashkë-infeksionit dhe procesi më gradual i mutacionit përshtates, ku aftësia e këtyre viruseve për t'u lidhur tek qelizat njerëzore shtohet pas çdo infeksioni.

Ri-llojzimi mund të çojë në një virus krejtësisht pandemik, që do të shprehet me një rritje të papritur të rasteve me një përhapje shperthyese. Mutacioni përshtates, i shprehur fillimisht në grupe të vogla rastetsh tek njeriu me një transmetim të kufizuar, do të japë botës ndofta disa kohë për të vepruar. Megjithatë nëse një kohë e tillë e "mëshirës" do të jepet, kjo nuk dihet.

4 Sistemi i paralajmërimit të hershëm është i dobët

Meqë evolucioni i kërcënimit nuk mund të parashikohet, nevojitet një sistem paralajmërues për të zbuluar shënjen e parë të ndryshimeve në sjelljen e virusit. Në vendet me risk, sistemet e informacionit të sëmundjeve, kapacitetet veterinarë dhe laboratorike janë të dobta. Shumica e vendeve të prekura nuk mund të kompensojnë siç duhet fermeret për pulat e therrura forcerisht (eliminuar), duke dekurajuar kështu raportimin e shperthimeve në zonat rurale ku janë shumica me e madhe e rasteve. Zgjerimi i shërbimeve veterinarë shpesh dështon në arritjen e këtyre zonave. Varferia rurale përjetëson sjelljet me risk të lartë, përfshirë therrjet tradicionale në shtëpi dhe konsumin e shpendëve të sëmure. Zbulimi i rasteve njerëzore frenohet nga një survejancë e dobët në këto zona. Diagnoza e rasteve njerëzore pengohet nga mbështetja e dobët laboratorike, kompleksiteti dhe kostot e larta të testimit. Pak vende të prekura kanë stafin dhe burimet e nevojshme për të hetuar terësisht rastet njerëzore dhe çka është më e rëndësishme të zbulojnë dhe hetojnë grupe rastesh, ky i fundit një sinjal thelbësor paralajmërues. Në pothuaj të gjitha vendet e prekura medikamentet antivirale janë në sasi të mangët.

Dilema e përgatitjes për një ngjarje potencialisht katastrofike por e paparashikueshme është e madhe për të gjitha vendet, por veçanërisht më tepër për vendet e prekura nga shperthimi me H5N1.

Këto vende, në të cilat fermat rurale janë shtylla kurizore e jetës ekonomike, kanë pësuar humbje të medha bujqesore, që aktualisht vlerësohen me tepër se 10 miliard dollarë amerikanë. Atyre po iu kërkohet të ruajnë, nese jo të intensifikojnë veprimtari që kërkojnë burime intensive që lypsen për të ruajtur shëndetin ndërkombëtar publik, ndërsa përpiqen me forcë për t'u perballur me shumë perparasi të tjera semundjesh infektive konkurruese.

5 Nderhyrja parandaluese është e mundur, por nuk është testuar

Nëse një virus pandemik do të fillojë të shfaqet përmes një procesi më gradual të mutacionit përshtatës, ndërhyrjet e hershme me medikamente antivirale, të mbështetur nga masa të tjera të shendetit publik, mund teoritikisht të parandalonin virusin që të përmiresonte transmetueshmërinë e tij, duke ndaluar kështu ose duke e vonuar përhapjen ndërkombëtare të pandemisë.

6 Reduktimi i semundshmërisë dhe vdekshmërisë gjatë pandemisë do të pengohet nga furnizimi jo i duhur me medikamente.

Vaksinimi dhe përdorimi i medikamenteve antivirale janë dy prej masave më të rëndësishme për reduktimin e semundshmërisë dhe vdekshmërisë së një pandemie. Me tendencën aktuale, asnjë prej këtyre ndërhyrjeve nuk do të jetë e disponueshme në sasi të duhur ose nuk do të shperndahet në menyre të barabarte në fillim të pandemisë si dhe për shumë muaj pas saj.

1 Te reduktohen mundesite për infektimin te njerezeve

Rreziku që një virus pandemik të shfaqet, varet nga mundësitë për ekspozim të njerëzve dhe infeksionet e tyre. Këto mundesi do të ekzistojnë për aq kohë sa virusi H5N1 të vazhdojë të qarkullojë tek kafshet. Kontrolli i sëmundjes tek kafshët është mënyra kryesore për të reduktuar mundësitë për infektimin e njerëzve dhe si rrjedhojë për të reduktuar mundësitë e shfaqjes së ndonjë pandemie të virusit. Parandalimi i sjelljeve që ekspozojnë njerëzit ndaj virusit është një mënyrë e dytë.

Shpresat që virusi të mund të eliminohej (zhdukej) me shpejtesë nga shpendet nuk është realizuar, dhe situata po bëhet më shqetësuese. Virusi në formën e tij më të lartë patogjen, tani është endemik në shumë pjesë të Indonezisë dhe Vietnamit dhe në disa pjesë të Kamboxhias, Kines, Tajlandës dhe ka mundësi gjithashtu në Republikën Demokratike Popullore të Laosit. Faktorët përgjegjës për rezistencën e virusit nuk janë kuptuar plotësisht. Dinamikat e sjelljes së H5N1 tek kafshet po ashtu nuk kuptohen mirë dhe nuk parashikohen. Patat shtepiake njihen se janë në gjendje të jashtëqisur sasi të mëdha të virusit shumë patogjen pa shfaqur shenja klinike. Speciet e gjitarëve që nuk mendohet të jenë të dyshimta për zhvillimin e infeksionit kanë shfaqur sëmundje gjatë koheve të fundit. Çrrenjosja e plotë e H5N1 në Azi ndoshta përjashtohet, kjo nga prezenca e tij në popullatat e shpendeve të egër. Kontrolli i infeksionit tek zogjtë e egër nuk është një opsion i mundshëm.

Pavarësisht nga këto vështirësi, kontrolli i sëmundjes tek shpendet mbetet një objektivi i mundshëm dhe një prioritet i lartë. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) dhe Organizata Botërore për Shëndetin e Kafsheve (OIE) kanë nxjerrë rekomandime të detajuara teknike dhe një dokument-draft të strategjisë globale për kontrollin në shtetet aziatike të prekura. Disa nga masat e rekomanduara kërkojnë ndryshime të ndjeshme në sistemet tradicionale të fermerëve dhe disa do të kërkonin më shumë kohë për t'u implementuar. Situata shqetësuese tek shpendet ka rritur mundësinë që pandemia e virusit të shfaqet, dhe kjo mund të ndodhë në një periudhë kohore më të shkurtër se ajo që nevojitet për kontroll.

Meqë pjesa më e madhe e rasteve tek njerëzit ka ndodhur në zonat rurale, keshilla për fermerët dhe familjet mbi mënyrën se si të shmangim ekspozimin është një rrugë e dytë për të reduktuar rrezikun e shfaqjes së një pandemie të virusit. Ky opsion ka mundësi të jetë më i vështirë. Fakti që patat shtepiake mund të veprojnë si një bartës "në qetësi" ka larguar sinjalin e paralajmërimit të rrezikut, veçanërisht tek fermerët rurale dhe familjet e tyre, dhe kjo rrit mundësinë për ekspozimin e pavetedijshëm të njerëzve. Shperthimet e infeksionit tek shpendet mund të jenë "në qetësi" për një arsye të dytë. Ekzistenca persistuese e virusit në pulat ka demtuar rendet e prekura. Një pamundësi për të kompesuar mjaftueshëm fermerët për zogjtë e humbur, redukton stimulimin për të raportuar shperthimet, veçanërisht në zonat rurale ku qendron risku i ekspozimit të njeriut.

Veprimet strategjike

- Të mbeshtetet strategjia e kontrollit të FAO/OIE

Rekomandimet teknike të FAO/OIE përshkruajnë masat specifike të kontrollit dhe shpjegojnë se si duhet të implementohen. Strategjia globale, e përgatitur në bashkëpunim me OBSH-në, e konsideron situatën urgjente nisur nga rreziku për shëndetin e njerëzve, duke përfshirë dhe atë që vjen nga pandemia, si pasojë e qarkullimit të vazhdueshëm të virusit tek kafshët. Strategjia adopton një metodë progresive, me opsione të ndryshme kontrolli të paraqitura në pershtatje me profile të ndryshme të semundjes, duke përfshirë faktore të tilla si densiteti i shpendeve, sistemet e fermave, dhe nëse infeksionet janë shfaqur në ferma komerciale ose ndërmarrje të vogla rurale. Vëmendja fillestare e propozuar është përqendruar tek Vietnam, Tajlanda, Kamboxhia dhe Indonezia., këtu vendet ku janë zbuluar rastet e infeksionit të njerëzve me H5N1.

Masa të qarta dhe të arritshme janë propozuar për vende të ndryshme dhe situata brenda vendeve. Vaksinimi është rekomanduar si një masë e pershtatshme kontrolli në disa, po jo në të gjitha situatat epidemiologjike. Masa të tjera në këtë strategji përfshijnë masa strikte bio-sigurie në fermat komerciale, përdorimi i koncepteve të ndarjeve dhe zonave, kontrolli i levizjes së kafsheve dhe produkteve, dhe një ristrukturim i industrisë të shpendeve në disa vende. Strategjia ve në dukje vullnetin e fortë politik për të zgjidhur problemin. Megjithatë, periudhat kohore për të arritur objektivin e kontrollit maten me vite.

Në korrik të 2005, vendet anetare të OIE miratuan standartet e reja, të njohura nga Organizata Botërore e Tregëtisë, specifike për gripin e shpendeve dhe që kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë të tregëtisë ndërkombëtare të shpendeve dhe produkteve të tyre. Standartet e reja mbulojnë metodat e survejancës, njoftimin ndërkombëtar të detyrueshëm dhe shenjat patologjike të larta ose ultra të gripit të shpendeve., përdorimi i vaksinimit, dhe sigurinë ushqimore nga produktet e pulave. Përbushja e këtyre standarteve duhet të jetë prioritet në kuadrin e përpjekjeve për të forcuar zbulimin në kohë, raportimin dhe përgjigjen në vendet aktualisht të prekura nga shpërthimi i gripit të shpendeve H5N1.

- Të intensifikohet bashkëpunimi midis sektoreve veterinar dhe atij të shëndetit publik

OBSH-ja do të caktojë staf të dedikuar që të rrisë shkëmbimin aktual të informacionit midis sektoreve të bujqesive dhe atij të shëndetësisë në nivelin ndërkombëtar. Shtimi i bashkëpunimit midis dy sektorve shërben për tre qëllime. Të lokalizojë zona të aktivitetit të semundjes tek kafshët ku duhet të shtohet vigjilenca për rastet njerëzore, të sigurojë se masat për kontrollin e semundjes tek kafshët janë të përputhshme me reduktimin e mundësive të njeriut për t'u ekspozuar ndaj virusit dhe të sigurojë se keshillat për komunitetet rurale për

masat mbrojtëse të mbeten në përputhje me natyrën ndryshuese të semudjeve në kafshe.

OBSH-ja do të ndermarre veprime të perbashkta me FAO dhe OIE për të kuptuar evolucionin e virusit H5N1. Që të arrihet këto objektive do të thotë përfundim dhe shkëmbim i një inventari të plotë të viruseve H5N1 nga njerëzit, pulat, shpendet e egra dhe kafshe të tjera .

OBSH-ja akoma thekson rëndësinë e kontrollit të sëmundjes në zonat rurale. Masat për të kontrolluar sëmundjen në kafshët shtëpiake konsiderojnë sesi të riftohet sa më mirë që të jetë e mundur prodhuesia bujqësore dhe tregëtia ndërkombëtare dhe ky objektivi pasqyrohet në objektivat e FAO /OIE. Ndërsa eliminimi i virusit nga popullatat komerciale të pulave do të ndihmojë në shërimin e bujqësisë, ai nuk mund t'ua reduktojë në mënyrë sinjifikative mundësitë për ekspozim të njeriut, pasi shumica e rasteve sot lidhet me ekspozimin ndaj grupe të vogla rurale të pulave. Asnjë rast nuk është zbuluar midis punonjësve që punojnë në pularite komerciale.

Strategjia e FAO/OIE pranon plotësisht se kontrolli i sëmundjes në oboret rurale do të jetë gjëja më e vështirë për t'u sfiduar. Mbeshtetja e fuqishme nga sektori shëndetësor siç shprehet nga OBSH-ja, ndihmon në formimin e vullnetit politik për të përballur sfidën. Përveç kësaj, është imperative që masat për kontrollin e sëmundjeve në stallat rurale të shoqërohen me komunikimin e riskut që i behet fermerëve dhe familjeve të tyre.

Një takim i perbashkët i FAO OIE OBSH në Malaizi në korrik 2005, trajtoi lidhjet midis sëmundjes tek kafshët dhe riskun e ekspozimit të njeriut dhe infeksionit dhe përcaktoi masat parandaluese që duhet të futen së bashku nga sektori veterinar. Përparësi iu dha nderhyrjeve në sistemin e fermave kopesht (te vogla) dhe të ashtuquajturve tregje të lagesht, ku pula të gjalla shiten në kushte dyndjeje dhe shpesh jo sanitare.

OBSH-ja, FAO dhe OIE kanë krijuar së bashku një Sistem Global të Paralajmërimit të Hershem dhe një Sistem Pergjigjeje për sëmundjet e kafsheve që kapërcejnë kufite .Mekanizmi i ri kombinon alarmin ekzistues për shpërthimet, verifikimin e pergjigjes reaguese të të tre agjensive dhe ndihmon që të behet gjurmimi (ndjekja) i sëmundjes në dobi të OBSH-se nga informacioni me i fundit mbi sëmundjet relevante të kafsheve. Sistemi formalizon shkëmbimin e informacionit epidemiologjik dhe orfron kuadrin operativ për misionet të perbashkta në terren në zoant e prekura

- Të përforcohet komunikimi i riskut për banoret rurale

OBSH-ja përmes rrjeteve të saj të kërkimit dhe në bashkëpunim me FAO dhe OIE do të përmirësojë kuptimin e lidhjeve midis sëmundjes tek kafshët, sjelljen njerëzore dhe riskun e marrjes së infeksionit H5N1. Ky informacion do të përdoret si bazë për komunikimin e riskut tek banoret rurale.

Sjellje të njohura mirë dhe të shmangshme me riks të larte të infeksionit vazhdojnë të hasen në zonat rurale. Nevojitet një komunikim i vazhdueshëm i riksut për të vene në gadishmeri banoret rurale ndaj ketyre risqeve dhe ti shpegojne sesi ti shmangin ato. Njohuri më të mira për sa I takon lidhjes midis kafsheve dhe semundjes njerezore, të perftuara nga OBSH-ja në bashkepunim me FAO/OIE mund të perdoren për të bere komunikimin aktual të riskut më të sakte keshtu edhe me të mirë për të parandaluar sjellje me risk.

- Të permiresohen qasjet për zbulimin në mjedis të virusit

OBSH-ja, FAO dhe OIE do të lehtesojne, permes rrjeteve të tyre kerkimore zhvillimin e shpejte të metodave të reja për zbulimin e virusit në kampionet mjedisore. Qellimi i ketyre metodave është për të perfituar një kuptim me të mirë të kushteve që rrisin riskun e infeksionit njerezor dhe prandaj favorizojne lindjen e një virusi pandemie. Një njohuri e tille nenvizon suksesin e parandalimit paresor të pandemise permes kontrollit të semundjes tek kafshët. Ai gjithashtu nenvizon keshillimin për banoret rurale për sjelljet që duhen shmangur. Mbeshitetja në survejancën veterinare rutine, e cila është e dobete në shumicën e vendeve me risk, nuk ka sjellë nje kuptim të duhur të lidhjes midis semundjes tek kafshet dhe asaj tek njerezit. Për shembull, në disa raste, shperthimet në pula zbulohen vetem pasi është konfirmuar një rast tek njeiu. Në raste te tjera, hetimi i rasteve tek njeriu nuk ka mundur të gjeje lidhjen me semundjen tek kafshët.

2 Të perforcohet sistemi i hershem paralajmerues

Ngjarjet e shpalosura ne pjese te Azise per me shume kane dhene alarmin e pergjithshem se nje pandemi mund te jete e afert. Nëqoftë se ky paralajmërim duhet te behet aq i sakte sa për të udhehequr veprimet kombetare dhe nderkombetare, atëhere survejanca dhe raportimi ne vendet e prekura duhet te permiresohet.

Pamjaftueshmeria aktuale e sistemit ekzistues të survejancës ka disa arsye. Disa vende kane mungesa kapacitetesh te nevojshme epidemiologjike dhe laboratorike për t'iu pergjigjur çdo lloj semundje qe shfaqet. Per sa i perket H5N1, testimet diagnostike konkluduese jane teknikisht te veshtira dhe te kushtueshme, dhe mund te jene te sigurta vetem ne disa institucione te pajisur ne menyre speciale. Survejanca dobeshohet nga fakti se shumica e rasteve kane ndodhur ne zonat rurale. Zbulimi i rasteve nderlikohet nga mbizoterimi i larte ne keto vende i rasteve te ndryshme te semundjeve te renda te frymemarrjes që kanë simptoma te ngjashtme

Shume aktivitete e percaktuara ne planet globale dhe kombetare te pergjigjes ndaj pandemise, nxiten nga ndryshime ne sjelljen e virusit. Zbulimi i ketyre ndryshimeve dhe interpretimi i tyre varet nga te dhenat epidemiologjike, klinike dhe virologjike ne kohe dhe te besueshme. Çdo rast i veçante tek njerezit jep te

dhena thelbësore për të vlerësuar riskun. Investigimi i grupeve të rasteve të aferteta në kohë dhe vendndodhje, ofron alarmin e parë për permiresimin e transmetueshmërisë së virusit. Studimet serologjike në kontaktet e ngushtë me pacientet, komunitetet që kanë raste të tilla dhe popullsinë që është me e risk të lartë, siç mund të jenë punonjësit e shëndetit, gjithashtu ofron një alarim të hershëm të ndryshimeve në sjelljen e virusit. Informacioni mbi ecurinë klinike të rasteve është po aq një shenje vitale, pasi sëmundjet me të buta me fatalitet të ulët priten të perkojnë me transmetueshmëri të permisuar të virusit.. Analizat e viruseve, të mbledhura gjatë survejancës nga laboratorët e OBSH-së dhe FAO/OIE, kanë zbuluar ndryshime në virus dhe gjithashtu kanë përcaktuar, nëse shfaqin transmetueshmëri të permisuar, duke punuar kështu për të konkretizuar rezultatet e mbledhura nga vezhgimet epidemiologjike dhe klinike. Po ashtu nevojiten studime të viruseve të mbledhur kohët e fundit për të siguruar se puna për zhvillimin e vaksinës vazhdon.

Veprimet strategjike

- Te permiresohet zbulimi i rasteve tek njerëzit

OBSH-ja do të ofrojë trajnimin, reagentet diagnostike, dhe mbështetjen administrative për verifikimin e jashtëm që duhet për permiresimin e shpejtësisë dhe besueshmërisë së zbulimit të rastit. Sot shumica e rasteve është zbuluar duke ndjekur rastet e shtrimeve spitalore për sëmundjet e frymëmarrjes. Spitalet në vendet e prekura kanë nevojë për mbështetje në zbulimin e rasteve, konfirmimin laboratorik dhe raportim. Përveç rolit të tij në një sistem të paralajmërimit të hershëm, konfirmimi i shpejtë laboratorik sinjalizon nevojën për të izoluar pacientet dhe për të menaxhuar ato sipas procedurave strikte të kontrollit të infeksionit dhe mund të ndihmojë kështu për parandalimin e rasteve të metejshëm.

Mbështetja diagnostike vazhdon të sigurohet nga laboratorët në rrjetin e OBSH-së. Megjithatë për shkak të simptomave fillestare të H5N1 që imitojnë shumë sëmundje që janë të zakonshme në këto vende, zbulimi i rasteve të sakta kërkon testimin e një numri të madh kampionesh. Permiresimi i kapaciteteve lokale është zgjidhja më e racionalë.

Për shkak të patogjenicitetit të lartë, H5N1 mund të mbahet e sigurtë vetëm nga një staf i trajnuar të punojë me laboratore të pajisur në mënyrë speciale duke punuar në nivel të lartë biosigurie. Këto lehtësira nuk ekzistojnë në shumicën e vendeve të prekura. Si një alternative, kapaciteti laboratorik mund të ngrihet duke forcuar sistemin aktual të qendrave të gripit ose nga sigurimi i laboratoreve levizës me ruajtje (siguri) të lartë. Aktivitetet mbështetëse përfshijnë trajnimin në metoda laboratorike për diagnostikimin e H5N1, shpërndarjen e reagenteve diagnostike moderne, dhe koordinimin e punës midis laboratoreve lokale dhe institucioneve epidemiologjike.

Nje infrastrukture duhet zhvilluar per te plotesuar testimin kombetar me verifikim te shpejte nderkombetar ne labororet e OBSH-se, vecanerisht sepse çdo rast i konfirmuar ofron te dhena thelbesore per te vleresuar riskun. Nderkohe kapaciteti per ta bere kete ekziston. OBSH-ja i ofron vendeve mbeshtetjen administrative te shpejte qe te dergoje kampjone jashte zonave te prekura. Forma te tilla asistence behen vecanerisht kritike kur ndodh nje grumbuj rastesh dhe kerkohet hetim.

- Te kombinohet zbulimi i shperthimeve te reja tek kafshet me kerkimet aktive ne rastet e njerzve.

Duke perdorur epidemiologe ne zyrat e vendit dhe kur eshte e nevojshme partnere te jashtem OBSH-ja do te beje qe zbulimi i shperthimeve te reja me patogjenicitet te larte te H5N1 në shpende te shoqerohet me kerkime aktive ne rastet njerezore. Surveilanca në disa vende ku H5N1 eshte konsideruar endemik në shpende eshte jo adekuate dhe ka dyshim te madh se rastet ne njerez nuk jane kapur. Kater raste ne njerez ne Kamboxhia u zbuluan vetem pasi pacientet kerkuan trajtim neVietnamin fqinj ku doktoret jane ne gadishmeri te larte dhe te familiarizuar me paraqitjen klinike te rasteve.

- Te mbeshteten hetimet epidemiologjike

Nje vleresim i besueshem i riskut varet nga hetimi i plote i rasteve sporadike ne njerez dhe grupe njerezish. Po pergatiten urgjentisht per perdorim ne trajnimet e ekipeve lokale udhezuesë per hetimin shperthimesh specifik nga H5N1 dhe te situates epidemiologjike ne vende te ndryshme. Keta udhezues i japin nje theks te vecante hetimit te rasteve dhe percaktimit nese ka ndodhur transmetimi nga njeriu ne njeri. Ekiye te mbledhura nga institucione te ndryshme nen organizmat „Alarmin e Shperthimit Global” te OBSH-se dhe „Rrjetit te Pergjigjes” mund te perdoren per mbeshtetje te shpejte investiguese ne terren .

- Te koordinohen kerkimet klinike ne Azi.

Te dhenat klinike per rastet njerezore duhet te plotesohen dhe te krahasohen, me qellim qe te ndrigojne metodat e transmetimit, identifikojne grupet ne risk dhe te gjejne trajtime me te mira. Puna per krijimin e nje rrjeti spitalesh ka filluar, modeluar nen ndikimin e rrjetit te survejances te OBSH-se, qe do merret me kerkimet klinike ne semundjet njerezore.

Rrjeti do te lidhe bashke spitalet kryesore ne Azi qe trajtojne paciente me H5N1 dhe kryejne pune kerkimore. Mbeshtetja teknike do te lejoje shkembim te shpejte te informacionit dhe ndarjen e kampjoneve dhe rezultateve te kerkimeve dhe do te inkurajoje perdorimin e protokolleve te standartizuara per trajtim dhe te procedurave per marrje kampjoni per hetim..

Identifikimi i grupeve me risk sherben si guide e masave parandaluese dhe nderhyrjeve te hershme. Ofrimi i te dhenave me cilesi te larte per ecurine klinike, rezultatet dhe trajtimi efikas, ploteson nje nevojte te qarte dhe imediate ne

vendet me raste në njerez. Pergjigjet e disa pyetjeve kyç si efikasiteti i ilaçeve antivirale, doza optimale dhe skedat pershkruese, mund te ndihmojne shërbimet shendetesore gjetiu tjeter tani qe pandemia eshte ne rruge e siper.

- Te perforcohet vleresimi i riskut

Operacionet e perditshme te OBSH-se kanë nevojë të perforcohen, qe te sigurojne mbledhje te vazhdueshme dhe verifikimin te informacioneve epidemiologjike dhe virologjike, esenciale keto per vleresim risku. Ministrite e shendetesise dhe institucionet e kerkimit ne vendet e prekura duhet te angazhohen teresisht ne mbledhjen dhe verifikimin e te dhenave. Ministrite e shendetesise dhe institucionet e kerkimit ne vendet e pa prekura duhet te ndihmojne ne vleresimin e rendesise se ketyre te dhenave dhe rezultatet duhet te nxirren shpejt. Keto aktivitete , aktualisht te koordinuara nga OBSH-ja, duhet te pershkalleshohen: viruset e gripit mund te evoluojne shpejt dhe ne nje menyre te papritur qe ndryshon vleresimin e riskut te shpejte, siç eshte evidentuar nga zbulimet e fundit te viruseve shume patogjene H5N1 ne zogjte shtegtare. Funksionet e rrjetit te laboratoreve te OBSH-se me ekspertize ne analizen e virusit te H5N1 mund te permiresohen nepermjet mjeteve siç jane: te dhenat gjenetike dhe nje bashkepunim i forte me rrjetet e laboratoreve veterinare per te bere qe viruset e kafsheve ashtu si dhe te njerezve te mbahen nen survejance te vazhdueshme.

- Te perforcohen qendrat ekzistuese kombëtare te gripit ne te gjithë rajonin e predispozuar per risk.

Shume qendra kombetare te gripit , te dizenuara nga WHO, tashme zoterojne infrastrukture te konsiderueshme ne formen e pajisjeve dhe personelit te trainuar. Mbeshtetjet shtese, veçanerisht ne formen e reagenteve diagnostike, mund te ndihmojne perforcimin e nje sistemi te hershem paralajmerimi ne vendet me predispozicin risku dhe fqinjet e tyre.

- Ti jepen stimul vendeve me predispozim per risk per te bashkepunuar ne menyre nderkombetare.

Premtimi i asistences eshte nje motivim i forte per te raportuar raste dhe per te shkëmbyer shembuj klinike ne rruge nderkombetare. Nje mbledhje e nivelit te larte duhet thirrur ne menyre qe kryetaret e shteteve ne vendet e industrializuara dhe ne vendet me risk mund te kerkojne zgjidhje dhe te arrijne marreveshje per ato lloj mbeshtetje qe konsiderohet si me e deshirueshmja nga vende te veçante.

3. Te frenohet ose vonohet perhapja ne burim

Disa konsultime nderkombetare mbi gripin pandemik kane kerkuar nga OBSH te shqyrtoje krijimin e nje rereve nderkombetare te barnave antivirale per perdorim strategjik ne prag te fillimit se nje pandemie. Ekspertet sugjerojne se masat agresive, te perqendruara ne perdorimin profilaktik te barnave antivirale, mund ta

kufizojne nje pandemi ne burimin e saj, ose te ngadalsojne perhapjen, duke fituar kohe per te marre masa emergjente dhe per te shtuar furnizimin me vaksina. Bazuar mbi rezultatet e modelimit matematik, mundesia teorike per te ndermarre nje veprim te tille perfundon shpejt. Sipas ketyre studimeve profilaksia antivirale duhet te arrije 80% te popullates se infektuar fillimisht, brenda rreth tre javeve nga shfaqja e simptomave ne personin e pare te infektuar nga shfaqja e nje virus pandemik. Studimet japin disa udhezime mbi sasite e barnave antivirale te nevojshme ne menyre qe strategjia te funksionoje. Ato gjithashtu nxjerrin ne pah domosdoshmerine e kombinimit te administrimit ne mase te barnave me masat e tjera, duke perfshire edhe karantinën e zones.

Nderkohe qe propozimi eshte interesant, suksemi i nje nderhyrje te tille varet nga disa hamendje: 1) Viruset e para qe paraqesin aftesi per ta ruajtur transmetimin midis njerezve nuk do te kene aftesi te medha transmetimi; 2) Shfaqja e ketyre viruseve do te jete e kufizuar gjeografikisht.; 3) Grupet e para te rasteve ne njerez te shkaktuara nga virusi do te zbulohen dhe raportohen menjehere dhe viruset do te identifikohen dhe karakterizohen ne menyre te shpejte. 4) barnat antivirale do te mobilizohen menjehere nga stoqet e rezerves , dhe do te vihen ne dispozicion te popullates se prekur dhe administrohen per nje numer te madh dhe te konsiderueshem njerezish ; dhe 5) Levizja e njerezve brenda dhe jashte zones do te kufizohet ne menyre efektive. Per shkak te sjelljes se paparashikueshme te viruseve te gripit , eshte e pamundur qe te dihet qe me pare nese dy hamendjet e para do te behen realitet kur nje virus shfaqet nje virus pandemik. Hamendjet e tjera marrin ne konsiderate nje kapacitet mbikqyrjeje dhe logjistike te persosur ne zonat fillestare te prekura, te kombinuar me aftesine per te perforcuar ndalimin e levizjeve.

Meqenese asnje perpjekje nuk eshte bere deri tani per te ndryshuar ecurine natyrore te nje pandemie duke nderhyre ne burimin e saj, suksemi i kesaj strategje ne ndalimin apo ngadalsimin e perhapjes nuk mund te sigurohet. Megjithate, barnat e rezerves, mund te perdoren gjithashtu per qellime trajtimi. Ne kete menyre, ekzistenca e nje rezerve nderkombetare ne dispozicion, ne prag te pandemise do te beje qe njerezit e prekur fillimisht dhe ne nevojje urgjente te perfitojne trajtimin me barna antivirale.

Veprime strategjike

- Te krijohet nje rezerve nderkombetare me barna antivirale.

OBSH do te krijojte nje rezerve nderkombetare te barnave antivirale per pergjigje te shpejte ne fillim te pandemise. Rezerva, eshte nje opsion strategjik qe i sherben si interesave te komunitetit nderkombetar, ashtu edhe atyre interesave te popullatave qe preken fillimisht. Çeshtjet qe duhen trajtuar jane çeshtjet e logjistikës te shoqeruara me shperndarjen dhe administrimin dhe licensimi per perdorim ne vende te veçanta. Mekanizmat per perdorimin e nje rezerve nderkombetare duhen percaktuar ne menyre me te sakte si lançuesit (sinjal-

dhenesit) epidemiologjike per shperndarjen e rezerves dhe grafiket e percaktuar per shperndarjen dhe administrimin emergjent. OBSH po bashkepunon me grupe qe merren me modelimin matematik si dhe me te tjere per te udhehequr zhvillimin e strategjive te kufizimit te hershem.

Ndersa ndjekja e ketij opsioni nuk ka garanci suksesi, ai prapeseprape lypset te ndermerret pasi ai perfaqeson nje prej opsioneve te paket parandalues per nje ngjarje me pasoja qe parashikohen te renda per çdo vend te botes

Kjo eshte gjithashtu garancia me e mire qe popullatat e prekura fillimisht te kene akses per barna trajtimi. Nese kufizimi i hershem deshton ne ndalimin e perhapjes se virusit, nje vonese ne perhapjen e gjere nderkombetare do te bente që te fitohej kohe per te intensifikuar procesin pergatitor. Eshte e pritshme qe shumica e qeverive te fillojne te ndermarrin masa emergjente vetem kur kercenimi per nje pandemi eshte i sigurt dhe i menjehershem. Nje kohe paraprirese prej nje muaj ose me teper per ta bere kete mund ti lejoje shume sherbime shendetesore te ngrene kapacitete dhe te bejne kalimin e nevojshem nga sherbimet rutine tek ato te emergjences.

- Te zhvillohen mekanizma te shperndarjes masive te barnave antivirale

Disa programe te OBSH, siç jane ato te pergjigjes emergjente ndaj shperthimeve epidemike te poliomielitit, fruthit, meningitit me prirje epidemike dhe etheve te verdha, kane fituar nje pervoje te konsiderueshme ne shperndarjen masive urgjente te vaksinave ne vendet ne zhvillim. Ekziston me pak pervoje ne drejtim te shperndarjes masive te barnave antivirale, ku administrimi komplikohet nga nevoja qe barnat te merren brenda disa diteve dhe nevoja per skema te ndryshme dozimi ne perputhje me perdorimin terapeutik ose profilaktik. OBSH do te zhvilloje dhe pilotoje mekanizma shperndarje prove per barnat antivirale ne bashkepunim me autoritetet shendetesore dhe industrine ne vend. Studimet do te vleresojne nivelet e mbulimit qe mund te arrihen, duke marre ne konsiderate nivelet e kenaqeshem dhe rruget per te mbeshtetur kete nderhyrje me ane te masave te tjera, sic eshte karantina.

-Te kryhet survejanca e ndjeshmerise antivirale

Duke perdorur rrjetin e saj ekzistues te laboreve te gripit, OBSH do te pregatise nje program mbikqyrjeje per testimine te ndjeshmerise antivirale, te modeluar mbi nje program te ngjashem per barnat antiturbekuloz. Perdorimi i nje rezerve nderkombetare qe synon te ndaloje nje shperthim epidemik do te perfshije administrimin e barnave ne nje numer te madh njerezish per disa jave. Duhet te krijohet nje mekanizem per monitorimin e ndonje ndryshimi qe mund te ndodhe ne ndjeshmerine e virusit ndaj ketyre barnave. Zhvillimi i rezistences ndaj barnave mund te kercenoje efektivitetin e rezervave kombetare te barnave antivirale te ngritura per perdorim te brendshem. Puna e qendrave bashkepunuese te OBSH per gripin dhe labororet e references per analizat e H5N1 mund te koordinohen per te perfshire testimin e ndjeshmerise antivirale.

4. Te reduktohet semundshmeria, vdekshmeria dhe problemet shoqerore

Vaksinat dhe barnat antivirale jane dy nderhyrjet mjekesore me te rendesishme per te reduktuar semundshmerine dhe vdekshmerine gjate nje pandemie, por ato nuk mund te jene te disponueshme ne sasirat e duhura. Vaksinat jane konsideruar boterisht si vija e pare e mbrojtjes. Barnat antivirale luajne nje rol kritik fillestar per arsye se furnizimi i tyre mund te jete jo i mjaftueshem per çdo vend ne fillim te pandemise. Autoritetet e te gjithë vendeve do te kene nevojë te ndermarrin shumicen e masave me natyre jo farmaceutike per te reduktuar semundshmerine, vdekshmerine dhe problemet shoqerore. Problemet e furnizimeve jo te pershtatshme me vakcina dhe aksesimi jo i barabarte ndaj tyre, duhet te trajtohen vecanerisht ne menyre urgjente.

Nderkohe qe as vijueshmeria kohore dhe as graviteti i pandemise pasardhese nuk mund te parashikohen. Historia tregon qe keto ngjarje cojne vazhdimisht ne nje rritje eksplozive te numrit te semundjeve dhe vdekjeve, te mjaftueshme per te paralizuar perkohesisht sherbimet publike dhe prodhimin ekonomik. Te gjitha qeverite duhet te pregatiten per te pershtatur sherbimet shendetesore perfshire njesite e kujdesit emergjent dhe intensiv dhe kapacitetin e morgut, per te perballuar nje rritje te papritur dhe te madhe te kerkeses. Nje tjetër pasoje do te jete mungesa nga puna ne te gjithë sektoret, me kapacitet perkohesisht te reduktuar ne sherbime publike thelbësore te tilla si kujdesi shendetesor, zbatimi i ligjit, transporti, sherbimet komunale dhe telekomunikacioni.

Bazuar ne pervojen e meparshme gripi pandemik nuk prek te gjitha vendet ose te gjitha pjeset e nje vendi ne te njejten kohe. Nese perpjekjet per te kufizuar nje virus perhapës ne burimin e tij deshtojne, autoritetet shendetesore mund te kene te pakten disa mundesi per te nderhyre ne parandalimin e perhapjes nderkombetare, brenda vendit dhe brenda komunitetit te prekur. Veprimet qe synojne ne vonesen e perhapjes duhet megjithate te ndermerren me shpejtesi. Te tre pandemite e shekullit te kaluar e pershkuan globin ne 6 deri 9 muaj. Qe prej te fundit qe ndodhi ne 1968, volumi i udhetimit ajror internacional u rrit ne menyre eksponenciale. Higjiena me e mire, gjendja e te ushqyerit dhe barnat per trajtimin e nderlikimeve dytesore te gripit, te hasur sot ne shume pjese te botes, pritet te zbusin disa nga pasojat shendetesore te pandemise, por ato duhet te vihen ne raport me gjasen qe ka sot shperndarja nderkombetare per te qene me e shpejte.

Sapo nje pandemi shperthen, udheheqesit politike do te jene nen nje trysni te madhe per te mbrojtur qytetaret e tyre. Vendet me plane pergjigjeje ndaj pandemise, te provuara paraprakisht idealisht, do te jene ne pozicionin me te mire per te marre vendime dhe per te vepruar me shpejtesi, sic pershkruhet ne Aneksin 1. Pervec kesaj, vendet duhet te sigurohen se kane legjislacionin e duhur qe i lejon autoritetet te ndermarrin dhe te zbatojne masa te jashtezakonshme.

Veprimet strategjike

- Te monitorohet evolimi i pandemise ne kohe reale.

Shume karakteristika te pandemise qe cojne ne perzgjedhjen e masave reaguese behen te dukshme vetem pasi virusi i ri shfaqet dhe fillon te shkaktojte nje numer te madh rastesh. OBSH, mbeshetur nga rrjete virtuale ekspertesh do te monitoroje sjelljen shpalosese epidemiologjike dhe klinike te virusit te ri ne kohe reale. Ky monitorim do t'iu jape autoriteteve shendetesore pergjigjet e duhura ndaj pyetjeve kyce rreth grupmoshave me rrezikun me te madh, infektivitetit te virusit, gravitetit te semundjes, niveleve te sulmit, rrezikut ndaj punonjesve te shendetesise dhe niveleve te vdekshmerise. Nje monitorim i tille gjithashtu mund te ndihmoje te percaktohet nese semundjet e renda dhe vdekjet shkaktohen nga pneumonia primare virale apo pneumonia sekondare bakteriale, e cila reagon ndaj antibiotikeve dhe si rrjedhim sherben si guide per ofrimin emergjent te funzimeve . Ekspertet ne modelimin matematik do te perfshihen ne ekipet vleresuese me te hereshem ne terren per te bere parashikimin e prirjeve ne menyre sa me te besueshme.

-Te futen nderhyrjet jo-farmaceutike

Pergjigjet ndaj ketyre pyetjeve do ti ndihmojne autoritetet te perzgjedhin masat, si mbyllja e shkollave, karantina, ndalimi i grumbullimeve masive te njerezve, kufizimet ne udhetim, ne perputhje me sjelljen e virusit, duke pasur ne kete menyre mundesine me te madhe per reduktimin e numrit te rasteve dhe vonesen e perhapjes gjeografike. OBSH ka prodhuar udhezues mbi perdorimin e ketyre masave ne nivele te ndryshme ne fillim te pandemise dhe pas shperndarjes se saj neper bote.

-Te perdoren barna antivirale per te mbrojtur grupet prioritare

OBSH rekomandon qe vendet me burime te mjaftueshme te investojne ne krijimin e rezerves se barnave antivirale per perdorim te brendshem, vecanerisht ne fillim te pandemise kur vaksinimi ne mase nuk eshte i mundur dhe grupet prioritare sic jane punonjesit e frontit te pare, duhet te mbrohen.

-Te shtohet furnizimi me vaksina

OBSH, ne bashkepunim me autoritetet e industrise dhe sistemit rregullues, ka futur procedura per zhvillimin dhe licensimin e vaksines pandemike. Gjithashtu jane zhvilluar edhe strategji qe bejne te arrihet maksimumi nga nje antigeni i paket vaksinor dhe si rrjedhoje duke lejuar qe sasi me te medha vaksinash te prodhohen pavaresisht nga limitet e kapacitetit te fabrikes ekzistuese. Aktivitetet per shpejtimin e prodhimit te vaksines dhe shtimit te furnizimit pershkruhen ne ankesin 2. Sapo deklarohet nje pandemi, te gjitha prodhuesit kalojne nga prodhimi i vaksinave stinore ne prodhimin e vaksines pandemike. Vendet duhet te trajtojne ceshtjet e detyrimeve qe mund te dalin nga administrimi ne mase i vaksines pandemike dhe te sigurojne strehim, logjistike dhe furnizime shtese, sic jane shiringat ne menyren e duhur.

-Te sigurohet akses i barabarte per vaksina

Ndervartesia e forte aktuale nga tregu do te thote qe komuniteti nderkombetar nuk mund te perballoje financiarisht lejimin e pjeseve te medha ne bote te perjetojne nje pandemi te pambrojtur nga vaksina. Argumentet humane dhe etike per te siguruar kete mbrojtje jane tashme te dukshme. Eshte ceshtje urgjente per OBSH-ne qe te hartoje nje proces politik qe synon ne gjetjen e rrugeve per rritjen e metejshme te kapacitetit te prodhimit ne menyre rrenjesore dhe per per ti bere vaksinat te perballueshme dhe te arritshme ne vendet ne zhvillim. OBSH gjithashtu do te punoje me agjensite donatore per ceshtjen e fundit

-Te komunikohet risku ne publik

Sapo nje pandemi deklarohet, autoritetet shendetesore duhet te fillojne procesin e vazhdueshem te komunikimit te riskut ne publik. Shume ceshtje te veshtira si:perhapja e paevitueshme ne te gjitha vendet, mungesa ne vaksina dhe barna antivirale, justifikimi per grupet prioritare te mbrojtjes, duhet te trajtohen. Komunikimi me efektivitetin e riskut, i mbeshtetur nga besimi ne autoritetet qeveritare dhe besueshmeria e informacionit te tyre, mund te ndihmoje ne zbutjen e problemeve shoqerore dhe ekonomike ardhur si pasoje e ankthit ne publik. Vendet keshillohen qe te planifikojne paraprakisht. Strategjia e komunikimit ne nje situatë pandemike duhet te perfshije trajnimet ne komunikimin ne rastet e shperthimeve epidemike dhe integrimin e komunikuesve ne ekipet e larta te menaxhimit.

5.Te kryhen kerkime shkencore qe paraprin masat reaguese

-Te vleresohen vecorite epidemiologjike te nje pandemie shperthyese

Ne fillim te pandemise, politike beresit do te perballojne nje nevojë urgjente per te dhena epidemiologjike mbi grupmoshat kryesore te prekura, menytrat e transmetimitdhe patogjenitetin. Keto te dhena do te mbeshtesin vendimet e menjehershme rreth grupeve te piketuara per vaksinim dhe marrje te barnave antivirale. Ato mund te perdoren gjithashtu per parashikimet mbi modelet lokale dhe boterore te perhapjes, si nje paralajmerim i hershem qe i ndihmon autoritetet kombetare te intensifikojne masat pergatitore. OBSH do te identifikojte qendrat epidemiologjike per mbledhjen e ketyre te dhenave dhe krijimin e protokolleve standarte te kerkimeve shkencore.

-Te monitorohet efektiviteti i nderhyrjeve shendetesore.

Disa nderhyrje jo-farmaceutike rekomandohen per reduktimin e perhapjes lokale dhe nderkombetare te pandemise per ngadalesimin e shkalles se transmetimit. Nderkohe qe shume nga keto nderhyrje jane provuar si te dobishme ne parandalimin dhe kontrollin e semundjeve te tjera infektive, efektiviteti i tyre gjate nje pandemie nuk eshte vleresuar kurre ne menyre gjithepershires. Nevojitet me shume informacion mbi tolerancen, efektivitetin dhe pranueshmerine ne popullata. OBSH do te krijojte qendra studimi dhe do te hartojte protokolle studimi per te vleresuar keto nderhyrje ne nivel lokal, kombetar dhe nderkombetar. Te dhenat krahasuese mbi efektivitetin e nderhyrjeve te ndryshme

jane gjithashtu te rendesishme, meqenese disa masa shoqerohen me nivele shume te larta te problemeve shoqerore.

-Te vleresohen pasojat mjekesore dhe ekonomike

OBSH do te ngreje qendra studimi dhe do te hartoje protokolle per vleresimin ne prespektive te pasojave mjekesore dhe ekonomike te pandemise, keshtu qe nderhyrjet e ardhme ne shendetesi do te ndryshojne ne perputhje me to. Ne te shkuaren, vleresime te tilla jane kryer vetem pasi pandemia ka perfunduar. Vlera e tyre si nje udhezues politik per shperndarjen e burimeve ka qene e manget per arsye te te dhenave jo te pershtatshme.

Aneksi 1 Strategjitë për përmirësimin e përgatitjes kombëtare

- Të asistohen vendet në zhvillim në planifikimin e prodhimit të vaksinave të tyre

Nevojitet urgjentisht mbështetje për disa vende nën risk të cilët po zhvillojnë vakcina të gripit apo që po ngrenë kapacitete të prodhimit të vaksinës. OBSH-ja do të koordinojë ofrimin e keshillimit me eksperte ndërkombëtarë, siç është kërkuar tashmë për të mbështetur të tilla përpjekje kombëtare. Një grup pune i OBSH-së do të ngrihet për të ofruar keshillime *ad hoc* për qeveritë në përpunime me nevojat, përparësitë dhe kapacitetet kombëtare. Detyra e grupit të punës do të jetë që të përfshijë mundësitë për vlerësim për transferimin e teknologjisë prodhuese në vendet në zhvillim dhe hartimin e projekteve pilote. Objektivi është që të rritet kapaciteti i prodhimit të vaksinës në një mënyrë eficiente dhe ekonomike, duke zgjeruar kështu aksesin si tek vaksinat stinore (në përpunime me përparësi kombëtare për kontrollin e semundjeve infektive) dhe vaksinave pandemike.

- Të mbështet planifikimi për përgatitjen ndaj pandemisë.

Nevojiten mjete për një vlerësim global të gjendjes së përgatitjes kombëtare. Vendet vazhdojnë t'i kërkojnë OBSH-së mbështetje në vlerësimin e planeve të tyre të përgatitjes, por nuk ka një mjet rajonal apo global për vlerësimin e gjendjes aktuale të përgatitjes në vende të veçante dhe lokalizim të dobësive që lypset të trajtohen. Një mjet i tillë mund të përdoret për të koordinuar mbështetjen bilaterale dhe multilaterale për përgatitjen në vendet në zhvillim. Përgatitja nga OBSH-ja e një shablloni të një plani pandemik do t'i jepte shumë vendeve në zhvillim një start avantazhues. Disa kurse fillestare rajonale trajnimi dhe takime janë përdorur për të vlerësuar gjendjen e përgatitjes kombëtare, dhe kjo mundësi lypset të shtrihet më tej.

- Të zhvillohen ushtrime modele të përgjigjes ndaj pandemisë.

Disa vende kanë zhvilluar ushtrime për të vënë në provë planet e tyre të pandemisë. Këto ushtrime janë konsideruar si sqaruese, duke rezultuar në një njohje të sakte të dobësive kritike në operacionet e përditëshme dhe formulimin e rekomandimeve të sakta për

korrigjimin e tyre. Një mekanizem i tille do të beje qe mesimet e nxjerra gjatë ushtrimit të një vendi mund të jene përfituese për vende të tjera.

Aneksi 2 Strategjite për përshpejtimin e zhvillimit të një vaksine pandemike

1 Të shkurtohet koha midis shfaqjes së virusit pandemik dhe fillimit të prodhimit komercial

- Të zhvillohen standarte për të siguruar cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e vaksinave të gripit

Standartet e OBSH-se u japin autoriteteve regullatore dhe prodhuesve norma ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të vaksinës, duke sjellë në këtë menyrë një njetrajtshmeri në furnizimin me vakcina. Në veçanti, kerkesat për një vaksinë të efektshme kundër H5N1 kërkojnë nevojën për norma ndërkombëtare që sherbejne si guide per bio-sigurine ne prodhimin e vaksinës. Për të mbeshtetur lejimin e dergesave (loteve) të vaksinës në të gjithë botën, nevojiten reagentë ndërkombëtare reference, të furnizuar permes OBSH-së për të kalibruar standartet rajonale, kombetare dhe të prodhimit. Gjithashtu lypsen standarte globale për të mbuluar përdorimin e propozuar me qeliza të reja për të ekonomizuar prodhimin e vaksinave.

- Te zgjidhjen çeshtjet e laboratoreve të shkelqyer dhe të çeshtjeve të sigurise.

OBSH-ja ka identifikuar një numer çeshtjesh teknike dhe regullatore që kerkojne zgjidhje.

Këto perfshijne specifikimet për testimin e pershpejtuar te sigurise se vaksinave kandidate, metodat laboratorike per testimin e vaksinave me adjuvante dhe shenjuesit e standartizuar të mbrojtjes për vleresime klinike. OBSH-ja duhet të mbledhe bashke ata qe merren me ligje, zhvilluesit e vaksinave dhe prodhuesit e tyre për të arritur një konsensus për këto çeshtje.

- Te harmonizohen menytrat për të liçensuar vaksinat e gripit pandemik

Një qendrueshmeri me e madhe nderkombetare në liçensimin e kerkesave për një vaksinë pandemike, përfshirë studimet që duhen për autorizim të makretingut, do të lehtësonin aksesin ndërkombetar tek vaksinat duke përshpejtuar disponueshmerine e tyre në vendet jo prodhuese. OBSH-ja mund të lehtësoje diskutimin mes autoriteteve regullatore për të zhvilluar procedura të harmonizuara për regjistrimin e vaksinave..

- Te trajtohen çeshtjet e sigurisë që lidhen me perdorimin e vaksines.

Cikli i shkurtër i prodhimit të vaksinës në mënyrë të pashmangshme kufizon studimet që kanë të bëjnë me sigurinë e saj përpara liqensimit, duke krijuar nevojën për një monitorim të sigurisë gjatë përdorimit të vaksinës. Zbulimi i problemeve do të kërkonte një punë kërkimore të shpejtë, e cila mund të koordinohet nga OBSH-ja në të gjitha vendet, duke përdorur një database mbi baze popullore.

- Të mbeshen strategji të prodhimit që ekonomizojnë përdorimin e antigjenit

Kapaciteti i kufizuar për prodhimin e përbajtës antigjenike të vaksinës është një faktor kritik kufizues. Strategjitë për prodhimin e vaksinave që janë të efektshme dhe që përdorin me pak antigjen, mund të rrisin shumë kapacitetin prodhues. Provat klinike nevojiten për të hartuar protokolle plotësuese dhe për të lehtësuar shkëmbimin e shpejtë të të dhënave paraklinike dhe klinike.

2 Të rritet furnizimi me vakcina të gripit

- Të gjenden mënyra për të kapërcyer hendekun midis kapacitetit aktual të prodhimit të vaksinave dhe kërkesës së pritshme gjatë pandemisë.

Duhet të gjehen mënyra për të siguruar se vendet pa kapacitet të brendshëm prodhues të kenë akses ndaj vaksinave të përballueshme financiarisht në sasi të duhura. Po ndiqen disa rrugë, përfshirë edhe strategjitë e kursimit të antigjenit, transferimin e teknologjisë dhe zhvillimi i vaksinave me kultura qelizore dhe ato me rikombinim gjenik. Shtimi i kërkesës për vaccine stinore zgjeron kapacitetin e përgjithshëm prodhues. Efektiviteti relativ dhe kostot e zbatimit për mënyra të ndryshme nuk janë pare ende. Kërkohet urgjentisht një plan veprimi, me rekomandime specifike për vendet me ose pa kapacitet prodhues të vaksinës

- Të përfshihen prodhuesit e vaksinës nga të gjitha vendet

Disa vende, përfshirë Republikën e Korese dhe Federatën Ruse, kanë kapacitete prodhuese por nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të koordinuara nga OBSH-ja

- Të mbesheteten përpjekjet në vendet në zhvillim, përfshirë edhe përmes përdorimit të transferimit të teknologjisë për zhvillimin dhe prodhimin e vaksinës.

Një mbështetje e tillë nevojitet urgjentisht për vendet me risk të lartë, përfshirë Tailandën dhe Vietnamin, të cilat po zhvillojnë vaccine të gripit ose po ngrenë kapacitete për prodhimin e vaksinës së gripit. Aktivitetet specifike janë paraqitur në aneksin 1

- Të rritet shfrytëzimi i vaksinës stinore të gripit në grupet me risk të lartë, në përputhje me shënjestrat e OBSH-së (50% mbulim në 2006 dhe 75% në 2010)

Arritja e këtij qëllimi kërkon leadership global në vlerësimin dhe komunikimin e progresit në mbulimin e gripit në vendet që kanë politika kombëtare për vaksinimin për grip dhe gjetiu në grupe të cenueshem. Aktivitete të tjera përfshijnë zhvillimin e rekomandimeve për të shtuar mbulesën me vaksine në grupet shenjester, mbeshtetja për zbatimin e programeve kombëtare të vaksinimit dhe përfundimi i të dhënave më të mira epidemiologjike dhe ekonomike lidhur peshën e gripit stinor në vendet në zhvillim.